



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 559, Datë 15.10.2018

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrjeje të re nga Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft dhe Schuler Aktiengesellschaft”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrjeje të re të krijuar nga Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft dhe Schuler Aktiengesellschaft

Baza ligjore: Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrjeje të re të krijuar nga Porsche AG dhe Schuler AG;

VËREN SE:

I. Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e ndodhur midis palëve Porsche AG dhe Schuler AG lidhur me krijimin e një ndërmarrjeje të re Joint Venture (JV) e zotëruar në masën XXX% nga secila prej tyre dhe ku këto dy shoqëri do të kenë kontroll të përbashkët.

Palët në transaksion janë:

Pala 1: Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, shoqëri e themeluar në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit gjerman. Shoqëria prodhon dhe merret me shitjen e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve dhe të pjesëve përbërëse dhe shërbime të tjera teknike; merret me ndërtimin e zhvillimin në fushën e ndërtimit të automjeteve dhe motorëve; merret me zhvillimin e përpunimin të të dhënave e prodhimit dhe shpërndarjen e produkteve të përpunimit të të dhënave, etj. Porsche është pjesë e grupit Volkswagen, një shoqëri me ofertë publike, me seli në Gjermani.

Në Shqipëri shoqëria është prezent përmes tre filialeve: Porsche Albania SHPK; Porsche Leasing SHPK dhe Porsche Mobility SHPK.

Pala 2: Schuler Aktiengesellschaft , është një shoqëri aksionare e themeluar në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit gjerman, aktiv në fushën e krijimit dhe prodhimit të makinave shtypëse të metaleve, proceseve të automatizuara, veglave, përpunimit të mënyrës se si realizohet një proces dhe shërbimeve për gjithë industrinë e përpunimit të metaleve si dhe atë të ndërtimit të automjeteve të lehta. Schuler i përket grupit austriak Andritz.

Shoqëria Schuler ofron në Shqipëri shërbime që lidhen me instalimin, ndërtimin, mbikëqyrjen dhe komisionimin e pajisjeve mekanike për hidrocentrale përmes degës shqiptare të ADRITZ HYDRO GmbH për klientë KESH dhe Energji Ashta.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërive Porsche dhe Schuler mbi një shoqëria të re, Joint-Venture, të sapokrijuar, me funksione të plota dhe palët në transaksion plotësojnë kufirin e xhiros së realizuar në tregun shqiptar dhe atë ndërkombëtar. Për këto arsye transaksioni bëhet objekt vlerësimi sipas nenit 10 dhe 12 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2008 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Shoqëria e re, Joint Venture, nuk do të operojë në Shqipëri.

Megjithëse Porsche AG dhe Schuler AG operojnë në Shqipëri nëpërmjet degëve të tyre në tregje të ndryshme, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, kështu që në lidhje me tregun shqiptar nuk identifikohen tregje të prekura. Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët mbi një ndërmarrjeje të re nga Dr.Ing.h.c.F.Porsche Aktiengesellschaft dhe Schuler Aktiengesellschaft;
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS